



Funded by
the European Union

EU4Youth



AGJENCIA
KOMBËTARE
E RINISË

Termat e Referencës — Koordinator Projekti | IPA EU4Youth 2022

TERMAT E REFERENCËS

Koordinator Projekti

Programi IPA EU4Youth 2022

Referenca: ACT-61341 / JAD.1030030

1. Përshkrim i Projektit

Agjencia Kombëtare e Rinisë së Shqipërisë (AKR) ka marrë 1,500,000 € nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programit IPA EU4Youth 2022 për të mbështetur fuqizimin e të rinjve në të gjithë vendin. Përmes këtij financimi, AKR po zbaton një skemë kombëtare grantesh që do të akordojë nën-grante për ndërmjet 31 dhe 38 organizatave të shoqërisë civile që punojnë drejtpërdrejt me të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç, me synimin për të arritur mbi 10,000 të rinj në të gjithë Shqipërinë.

Organizatave të financuara do të zbatohen projekte në dy fusha tematike: pjesëmarrja qytetare e të rinjve, vullnetarizmi dhe lidhësi, nga njëra anë, dhe sportet gjithëpërfshirëse, mirëqenia dhe rekreacioni, nga ana tjetër. Aktivitetet do të përfshijnë fushata ndërgjegjësimi, evente komunitare, veprime qytetare të udhëhequra nga të rinjtë, si dhe iniciativa sportive të bazuara në shkolla dhe komunitet, me një fokus të fortë në përfshirje — veçanërisht për vajzat, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë nga komunitetet minoritare dhe rurale.

2. Objektivi i Pozicionit

Koordinatori i Projektit luan një rol qendror në sigurimin e zbatimit koherent, në kohë dhe me cilësi të lartë të projektit EU4Youth. Duke raportuar drejtpërdrejt tek Drejtori i AKR-së, Koordinatori i Projektit është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin operacional të përditshëm të projektit, duke vepruar si pika kryesore lidhëse ndërmjet njësive të brendshme të AKR-së, ekipit të projektit, përfituesve të nën-granteve dhe aktorëve të jashtëm, përfshirë Delegacionin e BE-së dhe Autoritetin Kontraktues. Roli kërkon një profesionist proaktiv, të orientuar drejt zgjidhjeve, i aftë për të menaxhuar një mjedis kompleks me shumë aktorë, duke ruajtur njëkohësisht përputhshmëri të plotë me rregullat e BE/IPA dhe standardet institucionale të AKR-së.

3. Key Responsibilities

Menaxhimi dhe Koordinimi i Projektit

- Të udhëheqë koordinimin operacional të përditshëm të projektit, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të realizohen në kohë, brenda fushës dhe në përputhje me planin e miratuar të punës.



- Të koordinojë ngushtë me Oficerin e Granteve për zbatimin dhe monitorimin e skemës së granteve, duke siguruar përputhje ndërmjet proceseve të menaxhimit të granteve dhe planifikimit të përgjithshëm të projektit.
- Të bashkëpunojë rregullisht me njësitë e financës, ligjit, komunikimit dhe monitorimit të AKR-së për të siguruar koherencë të brendshme dhe përputhshmëri institucionale gjatë gjithë ciklit të projektit.
- Të përgatisë dhe mirëmbajë plane pune të përditësuara, kalendarë zbatimi dhe regjistra të rrezikut, duke sinjalizuar në mënyrë proaktive çështjet tek Drejtori i AKR-së.
- Të organizojë dhe drejtojë mbledhje të brendshme koordinimi me ekipin e projektit, duke siguruar që vendimet të dokumentohen dhe të ndiqen.

Marrëdhëniet me Palët e Interesit dhe Aktorët e Jashtëm

- Të shërbejë si pika kryesore operationale e kontaktit me Delegacionin e BE-së dhe Autoritetin Kontraktues, duke siguruar komunikim në kohë dhe profesional.
- Të koordinojë me përfituesit e nën-granteve dhe partnerët e shoqërisë civile për të mbështetur zbatimin e qetë, zgjidhjen e çështjeve operationale dhe përputhshmërinë me kushtet e grantit.
- Të përfaqësojë AKR-në në evente të lidhura me projektin, grupe pune dhe takime ndër-institucionale sipas nevojës.
- Të lehtësojë shkëmbimin e njohurive dhe ndarjen e mësimave midis përfituesve të nën-granteve, partnerëve dhe institucioneve kombëtare.

Raportimi dhe Përputhshmëria

- Të mbikëqyrë përgatitjen dhe dorëzimin në kohë të raporteve narrative të ndërmjetme dhe përfundimtare tek Autoriteti Kontraktues, në koordinim me Oficerin e Granteve dhe ekipin financiar.
- Të sigurojë përputhshmëri të plotë me kërkesat e dukshmërisë së BE-së, rregullat e prokurimit dhe procedurat IPA në të gjitha aktivitetet e projektit.
- Të monitorojë progresin e përgjithshëm të projektit kundrejt logframe dhe planit të punës, duke identifikuar devijimet dhe propozuar masa korigjuuese.
- Të sigurojë që dokumentacioni i projektit të mbahet i saktë dhe i plotë në përputhje me kërkesat e auditimit.



Mbikëqyrja e Skemës së Granteve

- Të ofrojë mbikëqyrje strategjike dhe operacionale të skemës kombëtare të granteve, duke mbështetur Oficerin e Granteve në organizimin e thirrjeve për propozime, proceset e vlerësimit dhe kontraktimin e përfituesve të nën-granteve.
- Të sigurojë që barazia gjinore, përfshirja sociale dhe parimet e dukshmërisë së BE-së të integrohen në të gjitha aktivitetet e financuara.
- Të mbështesë hartimin dhe ofrimin e mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve për përfituesit e nën-granteve, kur është e nevojshme.

4. Objektivat e Performancës

Koordinatori i Projektit pritet të arrijë rezultatet kyçe të mëposhtme gjatë angazhimit:

- Realizim në kohë dhe me cilësi të të gjitha aktiviteteve të projektit në përputhje me planin e miratuar të punës dhe logframe.
- Koordinim efektiv ndërmjet të gjithë anëtarëve të ekipit të projektit, njësisë të AKR-së dhe palëve të jashtme të interesit.
- Dorëzim i saktë dhe në kohë të të gjitha raporteve narrative tek Autoriteti Kontraktues.
- Përputhshmëri e plotë e skemës së granteve dhe aktiviteteve të projektit me rregullat e BE/IPA dhe kërkesat e dukshmërisë.
- Dokumentacion i projektit i mirëmbajtur dhe i përditësuar, i disponueshëm në çdo kohë për qëllime monitorimi dhe auditimi.

5. Kohëzgjatja e Angazhimit

Ky është një pozicion me kohë të plotë, i rregulluar nga legjislacioni shqiptar i punës. Kontrata fillestare e punësimit do të jetë për një periudhë 24-mujore. Zgjatja përtej periudhës fillestare i nënshtrohet performancës së kënaqshme, siç vlerësohet përmes një rishikimi formal të performancës, si dhe vazhdimësisë së financimit të projektit dhe nevojës përkatëse.

6. Kualifikimet dhe Përvoja

Të detyrueshme

- Diplomë universitare në shkencat sociale, ekonomi, administratë publike, informatikë, drejtësi, marrëdhënie ndërkombëtare ose një fushë të ngjashme. Një diplomë Bachelor e kombinuar me të paktën 2 vite përvojë drejtpërdrejt relevante do të konsiderohet ekuivalente.



- Përvojë e provuar në koordinimin e palëve të interesit dhe menaxhimin e partneriteteve me shumë aktorë.
- Njohuri solide mbi parimet e menaxhimit të projekteve të BE-së, kërkesat e raportimit dhe standardet e përputhshmërisë.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe shqipe, në të shkruar dhe në të folur, duke përfshirë aftësi të forta në hartim dhe raportim. Niveli i anglishtes minimalisht C1.
- Njohuri të mira të aplikacioneve MS Office; njohja me mjete të menaxhimit të projekteve përbën avantazh.

Avantazh

- Përvojë direkte me programe të financuara nga IPA ose skema grantesh të BE-së.
- Përvojë pune me ose brenda institucioneve publike, agjencive kombëtare ose organizatave të shoqërisë civile.
- Njohuri mbi politikat rinore, pjesëmarrjen qytetare ose programet e përfshirjes sociale.

7. Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim

Agjencia Kombëtare e Rinisë është e angazhuar për mundësi të barabarta në punësim. Të gjithë kandidatët do të merren në konsideratë pa dallim gjinie, moshe, aftësie të kufizuar, origjine etnike, feje apo çdo karakteristike tjetër të mbrojtur, në përputhje me Kodin e Punës të Shqipërisë (Ligji Nr. 7961/1995, i ndryshuar) dhe parimet përkatëse të BE-së. Aplikimet nga gratë dhe grupet e nënpërfaqësuar inkurajohen veçanërisht.

8. Konflikti i Interesit

Të gjithë kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kërkohet të plotësojnë dhe nënshkruajnë një Deklaratë të Konfliktit të Interesit përpara fazës së testit me shkrim. Kandidati i përzgjedhur do të kërkohet të deklarojë çdo konflikt aktual ose potencial interesit në çdo moment gjatë angazhimit të tij/saj dhe duhet të veprojë në përputhje me politikat e etikës dhe integritetit të projektit.

9. Linja e Raportimit

Koordinatori i Projektit do të raportojë drejtpërdrejt tek Drejtori i AKR-së. Për menaxhimin operacional të aktiviteteve të projektit, Koordinatori i Projektit do të punojë në koordinim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me Oficerin e Granteve, ekipin financiar dhe të gjitha njësitë e brendshme përkatëse të AKR-së. Koordinatori i Projektit do të shërbejë gjithashtu si ndërfaqja kryesore operationale me Delegacionin e BE-së dhe Autoritetin Kontraktues.



10. Vendndodhja

Pozicioni do të jetë i bazuar në Tiranë, Shqipëri. Do të kërkohen udhëtime periodike brenda vendit për vizita monitorimi në terren, evente rajonale dhe takime me palët e interesit. Shpenzimet e udhëtimit të kryera gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare do të mbulohen në përputhje me politikat e brendshme të AKR-së dhe dispozitat buxhetore të projektit.

11. Procedura e Aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme me email:

- Curriculum Vitae (CV) i përditësuar në format Europass ose ekuivalent, në anglisht.
- Letër motivimi (maksimum 1 faqe) që përshkruan përvojën relevante dhe motivimin, në anglisht.
- Kopje e diplomës më të lartë akademike.
- Dëshmi të përvojës relevante të punës (p.sh. letra reference, vërtetime punësimi ose ekuivalente).

Aplikimet duhet të dërgohen në: info@rinia.gov.al

Afati i aplikimit: 13 Prill 2026

Vetëm aplikimet e plota të marra brenda afatit do të merren në konsideratë. Aplikimet e dorëzuara pas afatit ose që mungojnë dokumentet e kërkuara do të shpallen të papranueshme në fazën B1.

12. Procesi i Vlerësimit

Aplikimet do të vlerësohen nga një Komision i pavarur Vlerësimi në tre faza të njëpasnjëshme. Kandidatët duhet të plotësojnë pragun minimal në çdo fazë për të kaluar në fazën tjetër. Vetëm kandidatët që marrin të paktën 75 pikë në total do të konsiderohen për emërim.

Faza	Metoda e Vlerësimit	Kriteret	Pikët Maksimale
B1	Administrativ & Kualifikim (Shqyrtim Dosjeje)	Plotësia e aplikimit; dëshmi e kualifikimeve; dëshmi e të paktën 3 viteve përvojë relevante; kopje e diplomës përkatëse; dëshmi e përvojës në projekte të financuara nga BE	15



Funded by
the European Union

EU4Youth



AGJENCIA
KOMBËTARE
E RINISË

Termt e Referencës — Koordinator Projekti | IPA EU4Youth 2022

B2	Test me shkrim	Njohuri mbi menaxhimin e projekteve të BE-së dhe procedurat IPA; aftësi planifikimi dhe koordinimi; kuptim i cikleve të menaxhimit të granteve; aftësi në hartim dhe raportim; njohuri mbi parimet e monitorimit dhe vlerësimit	60
B3	Intervistë	Aftësi lidshipi dhe koordinimi; menaxhim i palëve të interesit dhe aftësi komunikimi; motivim dhe përputhje me objektivat e projektit; aftësi për të menaxhuar mjedise komplekse me shumë aktorë; zgjidhje problemesh nën presion	25
TOTAL			100

Kandidatët që nuk arrijnë pragun minimal prej 75 pikësh në total nuk do të konsiderohen për emërim, pavarësisht renditjes së tyre krahasuar me kandidatët e tjerë.

Të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit do të nënshkruajnë një Deklaratë të Konfliktit të Interesit përpara fillimit të procesit të vlerësimit.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (National Youth Agency of Albania)